

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “EHMT” SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë “EHMT” SHPK, nga këtu e më poshtë referuar edhe si “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “SHPK”.

2. Ortakët e shoqërisë

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Erjon HOTI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1991 banues në Tiranë, identifikuar me Nr. J10504119P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Servirjen e produkteve ushqimore të standardizuara të përbërë nga hamburger, panine, sallatë, sandwich, në servirjen e ushqimeve të shpejta, fast food.
- Bar kafe.

4. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Tiranë, Rruga “Myslym Shyri”, pallati 10, Shkalla 1, Kati 1.

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë, ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

6. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Lekë (**dhjetë mijë lekë**). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: **Z. Erjon HOTI**, kontribut në para, 10,000 Lekë (**dhjetë mijë lekë**), kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë 100%.

7. Organet vendimarrëse të Shoqërisë

Organet vendimarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori

8. Emërimi i Administratorit



Administratori emërohet për një mandate 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

Administratori i parë i shoqërisë emërohet **Z. Erjon HOTI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.05.1991 banues në Tiranë, identifikuar me Nr. J10504119P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

9. Prishja dhe Likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësive paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve Themelues

Datë: 09/09/2024

Z. Erjon HOTI

